

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Përshkrim i shkurtër i procedurës: Fillimi i procedurave për dhënie me qira me anë të konkurrimit publik të sipërfaqes prej 0.22 ha, Ngastra nr. 106 (pjesë e Fondit Pyjor/Kullosor Publik), që i përket Ekonomisë Pyjore Gomsiqe, “për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, shoqërore, shëndetësore dhe mjedise sportive ,shplodhëse, kulturore etj)”, sipas udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”.
2. Çmimi dysHEME i fillimit të konkurrimit: është 110,000 lekë/ha vit dhe për 0.22 ha është 24,200 lekë në vit në sipërfaqe të llojit “Pyll Trungishte”, e përlogaritur kjo sipas VKM-së nr. 559, datë 29.7.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, dhe sipas Raportit mbi Studimin TeknikoEkonomik, përgatitur nga specialistët e fushës.
3. Qëllimi i përdorimit: është dhënia në gëzim të përkohshëm të sipërfaqes pyjore “për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, shoqërore, shëndetësore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj)”.
4. Pikët vlerësuese sipas kriterëve të konkurrimit për subjektet pjesëmarrëse në konkurrim, sipas pikës 14 të udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”, do të jenë :

Nr .	Lloji i Kriterit	Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues (e shprehur në pikë)
1.	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	20
2.	Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15
3.	Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	25
4.	Nivelin e punësimit në veprimtari	5
5.	Masën e qirasë për lek/ha/vit	35

5. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin sipas pikës 10 të udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kulloror Publik”, si vijon:

- a) Kërkesë së bashku me të dhënat për sipërfaqen e kërkuar dhe gjeneralitetet e tyre;
- b) Ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar, (i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit);
- d) Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e) Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g) Nivelin e punësimit në veprimtari;
- h) Lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar/ Raportin e vlerësimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të certifikuar (VNM);
- i) Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- j) Adresën e subjektit, telefon, email, dhe faks;

6. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim, sipas pikës 11 të udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kulloror Publik”, janë:

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

7. Vendi i zhvillimit të konkurimit: (Adresa): Zyra e Drejtorisë së Pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Bashkia Vau Dejës.

8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: me datë 26.10.2023, ora 12:00.

9. Informacion mbi Dokumentet e Konkurrimit Publik:

Dokumentet e Konkurrimit Publik mund të tërhiqen pranë Autoritetit Qiradhënës

Dokumente me pagesë:

Po X Jo

Nëse Po

Monedha leke Çmimi 1500

Dokumentet Standarde të Konkurrimit Publik përbëhen nga:

- Formulari i Njoftimit;
- Kërkesa për Pjesëmarrje;
- Formulari i Sigurimit të Ofertës;
- Formulari i Ofertës;
- Ftesa për Ofertë;
- Formulari i Njoftimit të Fituesit;
- Formulari i Publikimit të Njoftimit të Fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët pjesëmarrës në kopje fizike, me postë ose dorazi, pranë Sekretarisë së Bashkisë Vau Dejës.